

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për çështje administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Ramiz Kuqi dhe Gani Avdiu, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, E.H. nga Prishtina, rr. ...”, SU 1/3-II-28, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, avokat E.B. nga Gjakova, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,(MMPH)–Agjencia Kadastrale e Kosovës ,(AKK),në çështjen juridike ,anulim i aktit administrativ- Aktvendimit të AKK nr. 03/013/07, të datës 09.02.2012, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A.nr.385/12, të datës 10.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë,11.08.2016, mori këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, E.H., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A.nr.385/12, i datës 10.03.2016, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar, kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës nr. 03/013/07 ,të datës 09.02.2012.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të ;Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe në drejtim të dispozitave të procedurës administrative për shkak se; në aktet administrative apo gjyqësore nuk është aplikuar ligji, përkatësisht se është aplikuar në mënyrë të gabuar, në procedurën e cila aktit i ka paraprirë nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës administrative dhe në procedurën e cila aktit i ka paraprirë është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendja faktike. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i goditur të anulohet në tërësi, si dhe Vendimi i të paditurës AKK-së, si të kundërligjshëm ,duke e vendosur vet çështjen ,apo që lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur të MMPH-Agjencia kadastrale e Kosovës, nr. 03/013/12 ,të dt.09.02.2012, është hudhë poshtë, kërkesa nr.133, e dt. 17.08.2006, dhe kërkesa, 03/013/07, e dt.27.12.2006, për anulimin e Vendimit për

Eksproprijim 07 nr.465-53/79, e dt.18.10.1979, të Sekretariatit për Financa të Komunës së Prishtinës, si e pa afatshme.

I pa kënaqur me vendimin e AKK-së, paditësi ushtron padi në gjykatë, në procedurë të konfliktit administrativ kundër të paditurës, MMPH-AKK. Gjykata themelore në Prishtinë, në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor në praninë e paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe pas administrimit të provave si në procesverbal, merr aktgjykimin e ankimaur, me të cilin e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e Aktvendimit të organit të paditur të AKK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e aprovon si të rregullt ,ligjor dhe të drejtë , sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, as të LPK, sipas pretendimeve në ankesë dhe as me shkelje të tjera cilat gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit të 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të atakuar me padi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, i cili aktvendim, i nxjerrë duke vendosur në riprocedurë sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr.A1165/08,të dt. 10.08.2011, i ka të parapara argumentet në të cilat është bazuar si në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar me hudhjen poshtë të kërkesave të paditësit si të pa afatshme, për anulimin e Vendimit për eksproprijim të vitit 1979, të cekur si më lartë.

Kolegji gjen se në gjykatën e shkallës së parë në procedurë gjyqësore si dhe në organin përfundimtar të paditur AKK, në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale me që paluajtshmëria lëndore është eksproprijuar në vitin 1979,gjer sa kërkesa për anulimin e vendimit për eksproprijim është parashtruar pasi që kanë kaluar afatet e lejuara ligjore. Sipas nenit 21 të Ligjit për eksproprijim të KSAK(Gaz. zyrt. e KSAK nr.21/78), ka qenë e paraparë se kërkesa për deeksproprijim mund të ushtrohet brenda afatit prej 10 vite nga dita e plotfuqishmërisë së Vendimit për eksproprijim ,dhe në bazë të nenit 10 Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për eksproprijim(“Gaz. zyrt. e Kosovës.nr.46/86) ,afati për parashtrimin e kërkesës për deeksproprijim është 5 vite, prej nxjerrjes së aktit përfundimtarë të eksproprijimit.

Po ashtu kolegji i aprovon si të bazuara dhe të drejta vlerësimet e organit administrativ dhe gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes lidhur me pretendimet e paditësit, se kërkesën për deeksproprijim e ka parashtruar në vitin 1994, sipas ligjit për Eksproprijim të Serbisë, sepse nuk mund të konsiderohet si vazhdim i procedurës së filluar në vitin 1994,kërkesa-apo urgjenca siç e thekson paditësi e paraqitur në vitin 2006,e po ashtu nuk ekziston bazë ligjore që të procedohet çështja sipas ligjit të RS Serbisë në zbatim në vitin 1994, si ligj më i favorshëm, pasi në periudhën sa është zbatuar ai ligj, nga organet e pushtetit të Serbisë në Kosovë, nuk është vendosur çështja.

Pretendimet ankimore si dhe theksimet ndër të tjera si në arsyetim të saj, “se në këtë çështje është dashur të aplikohen dispozitat ligjore të Ligjit për eksproprijim të Serbisë i cili ka qenë në fuqi me 06.10.1994,si ligj më i favorshëm pasi që sipas tij nuk ka afat të limituar sa i përket të drejtës për deeksproprijim, se dispozitat e atij ligji nuk janë në kundërshtim me kushtet si parashihen në nenin 4 të Rregullores 1999/24,se procedurën e deeksproprijimit e ka filluar në vitin 1994, andaj gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin me shkelje të dispozitave të

nëntin 182 par.2 pika n),të LPK për arsye se nuk ka pasur arsye për faktet vendimtare”, etj, kolegji i shqyrtoi me kujdes në baza ligjore dhe i vlerëson se janë të pa bazuara jo të qëndrueshme dhe jo me ndikim për vendosjen e çështjes ndryshe nga ajo e vendosur, në organin e paditur AKK, e po ashtu nuk dëshmohet se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje procedurale apo ligjore të dispozitave të LKA apo të LPK, dhe gjithashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë, se paditësi i ka lëshuar afatet ligjore për parashtrimin e kërkesë për anulimin e vendimit për eksproprijim të vitit 1979,ashtu siç kanë qenë të rregulluara afatet me ligjet e lartë cekura për eksproprijim, gjer sa afatet ligjore janë prekluzive, andaj edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë. Pretendimet e tjera të cekura si më lartë kolegji i refuzon po ashtu si jo të bazuara sepse paluajtëshmëria lëndore është eksproprijuar në vitin 1979, sipas ligjit i cili ishte në fuqi, e jo sipas dispozitave të ligjit të RS Serbisë , dhe në periudhën kohore sa është aplikuar ky ligj nuk dëshmohet se është vendosur me një vendim përfundimtar, e gjithashtu nuk mund të justifikohet në baza ligjore që kërkesa e ushtruar në vitin 1994, për anulimin e vendimit të eksproprijimi në vitin 1979,të llogaritet si kontinuitet i procedurës së filluar sipas kërkesës të parashtruar në vitin 2006 ,pra pas rreth 12 vite, pasi që nuk dëshmohet me asnjë provë se brenda kësaj periudhe ka vazhduar procedurën sipas ligjit, gjer sa sipas Rregullores së UNMIK nr.1999/24,mbi zbatueshmërin e ligjeve në Kosovë, të zbatueshëm kanë qenë Ligjet e Kosovës në fuqi për Eksproprijim, (Ligji nr.21/78 i KSAK, dhe Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji nr.46/86).

Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata e apelit konstaton se në këtë çështje juridike administrative nga gjykata e shkallës së parë dhe nga organi administrativ i paditur drejtë është vendosur çështja dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vërtetohet si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.177/2016, me datë 11.08.2016

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani